

GJYKATA THEMELORE NE PRISHTINE –DEGA PODUJEVË, Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni Civil, si gjykatë e shkallës së parë, me gjyqtarin Binak Duqi dhe sekretaren juridike-praktikanten Blerina Sylejmani, në ceshtjen civilo – juridike të paditeses N.L. nga fsh.B. K.P., kundër të paditues Komuna e Podujeves – DKA, e perfaqësuar nga F.R. me autorizim, për anulim të konkursit Nr.05-226, në shqyrtimin kryesor, publik, të mbajtur në prani të paditeses dhe perfaqesuesit të paditues, me dt.25.10.2018, mori këtë:

A K T G J Y K I M

REFUZOHET kerkesëpadia e paditeses N.L. nga fsh.B., K.Podujevës **SI E PA BAZUAR**, kundër të paditues Komuna e Podujevës – DKA, me të cilën ka kerkuar që të: Anulohet vendimi i të paditues dt.28.08.2015 nr.05-244, lidhur me konkursin për mësimëdhënës për vitin shkollor 2015-2016 nr.05-226 i dt.28.07.2015 për shkak të pavlefshmerisë absolute. Të gjitha veprimet juridike të shkaktuara nga akti i pales së paditur nuk do të krijojnë asnjë efekt juridik dhe si të tilla ato konsiderohen si të pavlefshme.

Që të urdherohet e paditura të përserisë konkursin për mësimëdhënës në shkollën fillore “N.G.”, në fsh.B. për lëndën Histori, duke respektuar procedurat ligjore dhe t'i vleresoj drejtë ashtu siq është paraparë me aktet ligjore dhe udhëzimet administrative në fusheën e arsimit si dhe të obligohet pala që t'i paguaj shpenzimet e procedurës në shumën prej 40 euro, në afat prej 7 ditësh, pas pranimit të këtij aktgjykimi, nën kercenim të përmbarimit me dhunë.

Secila palë i bartë shpenzimet e veta procedurale.

A r s y e t i m

Paditesja N.L. nga fsh.B. K.P., pranë kësaj gjykate kishte ushtruar padi kundër të paditues Komuna e Podujevës – DKA, për anulimin e konkursit nr.05-226 të dt.28.07.2015. Gjykata ka nxjerrë aktgjykim me dt.30.05.2016 C.nr.492/15 duke i refuzuar kerkesëpadinë e paditeses si të pa bazuar. Pas ushtrimit të ankesës nga ana e paditeses kunder aktgjykimit Gjykata e Apelit të Kosoves në Prishtinë me Aktvendimin e saj CA.nr.2902/2016 dt.03.04.2018 e ka prishur aktgjykimin e kësaj gjykate dhe ceshtjen e ka kthyer në rigjykim. Duke konstatuar shkelje të procedurës dhe duke e urdhëruar që të shqyrtoj procedurën e rekrutimit dhe përzgjedhjes së kandidatëve për vendet përkatëse të punës, duke i shikuar kushtet e përcaktuara sipas konkursit të dt.28.07.2015 ku DKA i ka publikuar kushtet për vendet e lira dhe se rekrutimi është bërë në përputhje me meritat personale në raport me kushtet e konkursit dhe në përputhje me ligjin dhe aktet nënligjore që e rregullojnë këtë process. Këto vërejtje dhe shkelje janë të obligueshme për gjykatën e instancës më të ulët nga gjykata e shkallës më të lartë. Për t'i eliminuar gjykata këto shkelje të konstauara e caktoj seancën e radhës në rigjykim me nr të ri lëndë C.nr 203/18, duke i ftuar palët në seancën e dt. 20.06.2018, 18.09.2018 dhe 25.10.2018. Paditesja në seancën dhe fjalën përfundimtare gjatë shqyrtimit kryesor ka deklaruar se mbetem pranë padisë dhe kerkesës së saj si dhe deklarimeve nga shqyrtimi i kaluar dhe të tanishme me propozim që gjykata t'a aprovoj atë në tërësi të bazuar dhe t'a detyroj të paditues t'a anuloi konkursin dhe të përseritet procedura e zgjedhjes së kandidatëve në SHFMU “N. G. “ në fsh.B., për

lëndën Histori. Gjithashtu gjykata t`i eliminoj shkeljet e konstatuara nga gjykata e shkallës më të lartë dhe të vendos drejtë dhe bazuar në ligje.

Shpenzimet e procedurës i kërkoj.

Në të pergjigjurit në padi, seancë dhe fjalën përfundimtare gjatë shqyrtimit kryesor e paditura nëpërmes të autorizuarit të saj ka deklaruar se: E kundërshtoj në tërësi padinë dhe kërkesëpadinë e palës paditëse. Gjukata e Apelit ka konstatuar shkelje në vendimin e shkallës së parë dhe ne jemi pergjigjur në të gjitha kërkesat e saj duke ofruar prova të mjaftueshme se kërkesa e palës paditëse është e pa bazuar. Më tutje ka deklaruar se mbetem pranë pergjigjes në padi dhe deklarimit në seancë. Konkursi i të paditues është shpallur në pajtim me UA-06/2015 dhe zakonisht konkursi hapet pas daljes se UA. Pas vlerësimit të komisionit për këtë vend pune është pranuar M.R. me nr.Total të pikëve prej 23, kurse paditesja ka grumbulluar 18 pike, pranda këtu nuk ka kurrfarë shkelje ligjore me pranimin e kandidatit në fjalë. Sa i përket kërkesës së GJ.Apelit se a ka pasur rreth të ngushtë të kandidatëve nëpërmes punëdhënësit mund të pranohet vetëm një kandidat i cili i plotëson kushtet e konkursit, pra në qoftëse është vetëm një kandidat. Formalisht nuk ka kriteret e seleksionimit sepse ato janë kushte të cilat duhet ti plotësoj kandidati në konkursin e shpallur dhe komisioni ka pergadit formular për vlerësim të kandidatëve e`i cili në këtë rast është i përbërë prej 7 pikave siq janë përvoja e punës, pergaditja profesionale, organizimi i orëve mësimore, metodologjia e mësimdhënjes, vlerësimi, gjithëpërfshirja dhe trajnimet nga MASHT –i.

Besoj se kemi dhënë skjarime të mjaftueshme që i ka kërkuar edhe Gjukata e Apelit lidhur me seleksionimin - formularët e vlerësimit dhe kemi dhënë sqarime të duhura lidhur me menyrën e pranimit të mesimdhënësve sipas konkursit të shpallur nga e paditura. Prandaj i propozoj gjykatës që padinë dhe kërkesëpadinë e paditeses t`a refuzoj në tërësi si të pa bazuar.

Shpenzimet e procedurës nuk i kerkoj.

Gjukata per të vërtetuar drejtë gjendjen faktike në këtë çështje kontestimore në procedurën e provave bëri administrimin dhe leximin e këtyre provave:

Sipas pëlqimit të palëve u lexuan provat të cilat janë administruar në procesverbal të dt.30.05.2016 C.nbr.492/15, aktgjykimi i kësaj gjykate 30.06.2016, ankesa e paditëses kundër aktgjykimit 21.06.2016, pergjigje në ankesë nga e paditura 30.05.2016, aktvendim i Gjukatës së Apelit të Kosovës në Prishtinë CA.nr.2902/16 dt.03.04.2018, procesverbal C.nr.203/18 dt.20.06.2018, formular mbi vlerësimin e kandidatëve për mësimdhënës dt.19.08.2015, për paditësen N.L., formular tjetër për kandidatin M.R. e njëjta datë, procesverbal i dt. 18.09.2018, parashtresë e të paditurës së bashku me prova 27.09.2018, konkursi për mësimdhënës për vitin shkollorë 2015/2016.

Pas vlerësimit të provave një nga një e të gjithave së bashku gjykata konform nenit 8 të LPK –së, gjeti se kërkesëpadia e paditeses është në tërësi e pa bazuar dhe si të tillë e refuzoj ashtu siq është cekur dhe në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Nuk është kontestues fakti se paditësja ka konkurruar në konkursin e shpallur nga e paditura me dt. 28.07.2015 për vendin e punes mësidhënese e lëndës Edukatë Qytetare dhe Histori sipas dokumentacionit të paraqitur tek e paditura kurse konkursi ishte shpallur per vendin e punës Histori në SHFMU “N.G.”, në fsh. B. K.P.

Nuk është kontestues fakti për gjykatën së në këtë vend të punës ishte pranuar kandidati M.R. kurse paditeses i`u kishte refuzuar kërkesa. Këto fakte vërtetohen pa dyshim nga provat materiale, thënjet në padi dhe pergjigje në padi si dhe deklarimi i palëve ndërgjigjëse në seancë.

Kontestues ishte fakti se kandidati i pranuar si mësimdhënës i Historisë në SHFMU “N.G.” M.R. a`i kishte plotësuar kushtet e konkursit të shpallur nga e paditura, se refuzimi i paditeses a ishte i drejtë, ligjor, apo

në kundërshtim me UA-06/15, UA-09/2014 për Normativin mbi Kuadrin Profesional të Arsimit të Pergjithshëm i Qeverisë së R.Kosovës, UA-17/2009 dt.28.08.2009-Procedura e zgjedhjes së personelit arsimor në shkollë, ligjin kundër Diskriminimit nr.2004/3, ligjin mbi Arsimin Parauniversitar në R.Kosovës nr.04/L-032, ligjin e Punes nr.03/L-212, Ligjin për arsimin në Komunat e R.Kosoves nr.03/L-068 siq pretendon pala paditëse se kandidati i pranuar është pranuar në kundërshtim me dispozitat ligjore të cekura më lartë kurse pala e paditur kundërshton pretendimet e palës paditëse duke theksuar se kandidati i pranuar është pranuar në pajtim me këto dispozita dhe kushtet e konkursit të hapur nga ana e saj pa bërë asnjë shkelje ligjore në këtë drejtim.

Gjykata pas vlersimit të thënjeve në padi, pergjigje në padi, deklarimit në seancë të palëve ndërgjyqëse, duke i vlersuar provat materiale që gjinden në shkresat e lëndës si dhe eliminimit të vërejtjeve dhe shkeljeve të konstatuara nga Gjykata e shkallës më të lartë të Apelit me vendimin e saj CA.Nr.2902/16 dt.03.04.2018, gjykata vërtetoi këtë gjendje faktike:

Sipas pergjigjes që i është kthyer paditeses nga e paditura DKA nr.Protokoli 05-061-93668 të dt.15.12.2014 me nr.05/515 e ka njoftuar paditesen se me rastin e shkuarjes së mësimdhënesit Xh.H. në pension e ka angazhuar përkohësisht në SHFMU “N.G.” në fsh.B. M.R. me kualifikim BA-Histori deri sa e paditura ta shpallë konkursin e qellimi ishte që nxënësit mos të humbin mësimin.

Nga ankesa e paraqitur nga ana e paditeses kunder njoftimit dhe shpalljes së listes për pranimin e kandidateve e jo dhe asaj vërtetohet se paditesja ka ushtruar ankesë kunder vendimit të DKA-P. me dt.09.09.2015 të vendimit dt.28.08.2015, për vitin shkollor 2015/2016 sipas konkursit të shpallur me dt.27.08.2015, me nr.Konkursi 05-226, në të cilin kishte konkuruar dhe paditesja.

Sipas njoftimit të dhënë nga Komisioni Komunal i paditures për ankesa gjykata vërteton se paditesja është njoftuar se cilët kandidat janë pranuar në shkollat për të cilat kishte konkuruar paditesja sipas konkursit të shpallur nga e paditura dhe atë M.R. në SHFMU “N.G.”, fsh.B. me kualifikim BA-Histori, i cili ka qenë edhe më parë në këtë shkollë në vitin shkollor 2014/2015 dhe L.H. në SHFMU “L.P.”, në fsh.D., me kualifikim BA-Histori.

Nga kërkesa e paditeses me dt.24.11.2014 gjykata vërteton se paditesja është ankuar të DKA në P. për menyren e pranimit të kandidatit M.R. në SHFMU “N.G.” në fsh.B. pas daljes në pension të mësimdhënesit Xh.G., se kjo është bërë në menyre kundër ligjore.

Nga pergjigja e dhënë prej DKA K.Podujevës i kthen pergjigje paditeses se kandidatet e pranuar nga e paditura janë të pranuar në pajtim me UA 06/2015 të dt.10.07.2015 të MASHT-it Qeveria e Republikës së Kosovës - Normativi Mbi Kuadrin Profesional të Arsimit të Pergjithshëm sipas nenit 5 pika 10.2 të tij që të dy me kualifikim BA-Histori Fakulteti Filozofik Univerziteti i Prishtinës.

Nga ankesa e paditeses drejtuar MASHT-it - Zyres së Inspektionit gjykata vërtetoi se paditesja është ankuar pranë këtij organi lidhur me menyren e pranimit të M.R. në SHFMU “N.G.” në fsh.B. në vend të mësimdhënesit Xh.H. pas shkuarjes së tij në pension. Kandidati është pranuar përkohësisht por në kundërshtim me ligjin e Punes 03/L-212, Ligji për Arsimin e Komunave të Kosovës nr.03/L-068 neni 5 pika c, UA 17/2009 për procedurën e zgjedhjes së personelit arsimor në shkollat neni 2 par. 1, UA 14/2011 për rregullimin e procedurave për themelimin e marrëdhënies së punës në sektorin publik dhe UA 09/2014 për normativin mbi kuadrin profesional të arsimit të pergjithshëm.

Sipas pergjigjes së dhënë nga MASHT-i- Zyra e Sekretarit të Pergjithshëm - Departamenti i pergjithshëm i Inspektionit të dt.22.04.2015 si pergjigje në ankesën e paditeses me dt.23.01.2015 thuhet se Inspektoret e Arsimit kanë bërë një inspektim special në DKA- Podujevë, kanë hartuar dhe procesverbal e duke i rekomanduar të paditures që për vendin e punës mesimdhënes i lëndës Histori në SHFMU “N.G.” në fsh.B.

të shpallë konkurs sipas rregullativës ligjore në fuqi qka dhe e paditura e ka bërë këtë duke hapur konkursin nr.05-226 dt.28.07.2015 dhe ka plotësuar vendin e punes në menyre ligjore.

Prandaj gjykata e vlereson se paditura nuk ka bërë kurrfarë shkelje në rastin konkret dhe ka zbatuar rekomandimin e Inspektorëve të Arsimit të MASHT-it duke e hapur konkursin për të plotësuar vendin e punes që kishte caktuar perkohesisht ta mbaj atë vend pune nga M.R. pas daljes në pension të Xh.H. Në këtë konkurs ka konkuruar dhe paditesja por nuk është pranuar pasi që kandidati M.R. kishte arritur të ketë më tepër pikë nga vleresimi i komisionit të caktuar nga e paditura. Pretendimet e paditeses janë të pa bazuara dhe pa mbështetura në prova pasi që pretendimet e paditeses dhe ankesa janë në kohën e para shpalljes së konkursit pra ai ishte perkohesisht aty per tu plotësuar më vonë me konkurs vendi në SHFMU “N.G.” në fsh.B.

Konkursin e saj me dt.27.08.2015 e paditura e ka hapur ne pajtim me UA 06/15 të dt. 10.07.2015 për Normativ Mbi Kuadrin Profesional të Arsimit të Pergjithshëm, në pajtim me Ligjin e Punes 03/1-212 neni 8 i saj - ku konkursi duhet të jetë i shpallur publik dhe i barabartë për të gjithë pa asnjë lloj diskriminimi, ashtu siq parashifet me këtë ligj dhe aktet tjera në fuqi. Procedura e zgjedhjes së kandidateve është në pajtim të plotë më këtë ligj, UA 06/2015 në nenin 5 paragrafi 10 pika 1 dhe 2 e tij. Sipas ketij neni paragrafi 10 pika 1, kërkohet që për vendin e punes Histori kandidati duhet të ketë kualifikimin Fakulteti i Edukimit program Histori - Edukatë – Qytetare kurse sipas nenit 5 paragrafi 10 nen piken 2 kandidati duhet t`a ketë të kryer Fakultetin Filozofik - Dega e Historisë. Pra UA në fjalë nuk li ka dhënë asnjëri paragraf por është kërkuar që njerin prej ketyre kualifikimeve të ketë kandidati që pretendon të jetë mesimedhenes për këtë lëndë. Andaj nuk qendron pretendimi i paditeses se neni 5 paragrafi 10 në piken 1 të UA ka përparësi në krahasim me piken 2 të paragrafit 10 neni 5 të ketij UA, sepse ato dallojnë vetem me rënditje e asesi me përparësi të njëres apo tjetres pikë të paragrafit 10 nenit 5. Sepse përpos ketij kualifikimi - pergaditjes shkollore të kërkuar sipas konkursit të hapur janë kerkuar nga kandidatet edhe kushte tjera që t`i plotesojnë dhe atëherë në bazë të vleresimit të gjithanshem për secilen kategori dhe grumbullimit të pikëve në pergjithësi janë vleresuar kandidatet që kanë tubuar më së shumti pike. Këtë më së miri e verteton Formulari i vleresimit të kandidateve për mesimedhenes i perpiluar nga e paditura DKA K.Podujevës ku shifet se kandidatet janë vleresuar për shtatë (7) pyetje –kategori nen.1 përvoja e punës, nen.2 pergaditja profesionale, nen.3 organizimi i ores mesimore, nen.4 Metodologjia e mesimedhenies , nen.5 Vleresimi, nen.6 Gjithperفشirja dhe nen.7 Trajnimet e akredituara nga MASHT-i. Secila kategori i ka nengrupet e veta. E paditura ka deklaruar se ne nuk kemi të nxjerrur vendim për kriteret e paraseleksionimit siq i është prezentuar nga paditesja për Komunen e Prishtines sepse secila Komunë e rregullon në menyren e vet, pra i vleresojm kandidatet në bazë të formularit. Gjukata këtë deklarim e merrë si të bazuar sepse është në tërësi në pajtim me provat tjera materiale që gjinden në shkresat e lendes dhe me të drejtë e paditura e kundershton pretendimin e paditeses se nuk ka nxjerrë vendim për kriteret e paraseleksionimit siq pretendon ajo se është dashur të nxjerrë Komuna.

Sipas Formularit të paditures dhe vleresimit të kandidateve për mesimedhenes për paditesen dt.19.08.2015 ajo e ka vleresuar atë me gjithsejtë 18 pikë sepse i ka munguar pervoja e punes si një nga kushtet elementare duke e vleresuar me 0 pikë, por ajo eshte vleresuar me 8 pike per pergaditjen e saj profesionale - shkollore kurse kunderkandidati tjetër i pranuar me më pak pikë të pergaditja profesionale - shkollore me 7 pikë por ai ka pikë të grumbulluara më shumë në kriteret - grupet tjera të vleresimit dhe është vleresuar me më shumë pikë të grumbulluara nga komisioni i paditures sesa paditesja.

Sipas formularit të paditures për kandidatin e pranuar M.R. sipas ketij konkursi të dt.28.07.2015 të dt.19.08.2015 ai është vleresuar me gjithsejtë 23 pikë të grumbulluara. Kjo vërtetohet dhe me rastin e paraqitjes së ankeses nga ana e paditeses me rastin e pranimit të kandidateve tjerë e jo dhe paditeses kur Komisioni në përberje prej Xh.Ll. si kryesues komisioni per shqyrtimin e ankersave dhe Z.Z. e S.G. si antarë të komisionit i kanë refuzuar ankesen dhe kanë njoftuar paditesen se në shkollat që ajo ka konkuruar janë pranuar kandidatë tjerë e jo ajo dhe ate: Në SHFMU “N.G.” në fsh.B. është pranuar M. R. në lenden Histori me kualifikim BA-Histori i cili kishte qenë mesimedhenes edhe në vitin shkollor të 2014-2015 dhe

L.H. në SHFMU “L.P.” si mesimedhenese e Historisë me pergaditje BA–Histori në fsh.D., njoftim i dt.21.09.2015.

Nuk ka të drejtë paditesja kur pretendon se e paditura ka shkelur dhe ka vepruar në kundërshtim me UA 09/2014 dhe UA nr.17/2009 te dt.28.08.2009 sepse ato udhezime janë të tejkaluara dhe qdo vit MASHT-i nxjerr Udhezimet Administrative të reja për qdo vit të ri shkollor para shpalljes së konkurseve nga Komunitet e R.Kosovës siq ka vepruar me nxjerrjen e UA 06/2015 me dt.10.07.2015 dhe UA nr.05/2015 dt.07.07.2015. Prandaj paditesja pa të drejtë pretendon se e paditura ka shkelur udhezimet e cekura nga ajo se ato kanë qenë të nxjerrura jashtë fuqie me nxjerrjen e UA të ri dhe ato nuk kanë fuqi retroaktive për rastin konkret. Andaj e paditura ka të drejtë në kundërshtimet e saja dhe gjykata i pranon si të bazuara dhe që ishte obligim i paditueses që me prova ti bëjë të bazuara kundërshtimet e saj siq kerkohet sipas nenit 7,1 lidhur me nenin 319 par. 1 dh2 te LPK –së.

Nuk ka të drejtë paditesja në pretendimin e saj se perzgjedhja e kandidatit tjetër në vendin e punës mesimedhenes ne SHFMU “N.G.” në fsh.B. është bërë në baza diskriminuese sipas nenit 4 të ligjit mbi diskriminimin sepse kjo nuk qendron. Konkursi nga e paditura ka qenë i hapur dhe publik ku kanë marrë pjesë qdo kandidat qe mendon se i ka plotësuar kushtet dhe secilit i është dhënë mundësia e barabartë për konkurim dhe vleresim, e krejt tjetër gjë është që e paditura ka pranuar kandidatin M.R. i cili ka pasur me shumë pikë të vleresuara nga e paditura sipas komisionit të saj të ngritur në pajtim me ligjet e për të cilat paditesja mendon se janë shkelur. Mundësia ju ka dhënë gjithë kandidatëve në menyre të barabartë pa kurrfarë diskriminimi. Sipas nenit 4 te Ligjit nr.2004/3 Kunder Diskriminimit pika a) thuhet se duhet krijuar kushtet për qasje në punësim, vetëpunësim dhe punësimin në profesion, përfshirë këtu kushtet e punësimit dhe kriteret e perzgjedhjes, pa marrë parasysh aktivitetin në të gjitha nivelet e hierarkisë profesionale dhe avansimit. E paditura i ka respektuar këto të drejta dhe nuk ka bërë diskriminim ndaj paditeses të asnjë forme përfshirë këtu kushtet e punësimit dhe kriteret e perzgjedhjes qoftë as mbi baza profesionale siq thotë paditesja, por vetem ka zbatuar ligjet, UA 06/2015, konkursin publik dhe kushtet e tij dhe në kushte plotësisht të barabarta ka zgjedhur kandidatin që është vlerësuar me më se shumti pikë.

Sipas paditeses e paditura me rastin e perzgjedhjes se kandidatit ka bërë shkelje te ligjit nr.04/L-032 ligji për Arsimin Parauniversitar në R.Kosovës dhe ligjit për Komunitet e Kosovës nr.03/L-068 kur me rastin e daljes në pension të mesimedhenesit Xh.H. në Korrik të vitit 2014 ka pranuar kandidatin M.R. Kjo nuk qendron sepse edhe më heret është theksuar se ajo ka ushtruar ankesë për këtë dhe në MASHT dhe për këtë arsye Inspektoret e Arsimit e kanë vizituar të padituesen që t`a konstatoj gjendjen pas ankesës së paditeses dhe i kanë rekomanduar të paditueses që për këtë vend pune të hapë konkurs sipas ligjeve në fuqi dhe e paditura e ka bërë këtë. Por kjo ceshtje nuk ka të bëjë fare me konkursin kur i është refuzuar paditeses per t`u pranuar si mesimedhenese sepse kjo eshte në Korrik 2014 kurse konkursi është në 28.07.2015. Kjo është bërë me qëllim që nxenesit të mos mbesin pa shkollë siq deklaroi e paditura. Nuk qendron pretendimi se kandidati i pranuar vetem sa është zyrtarizuar sepse ai si gjithë kandidatet e tjerë ka konkuruar në këtë konkurs dhe është vlerësuar si gjithë tjerët më të njejtat kushte dhe kriteret duke arritur të tuboj më se shumti pikë sipas vlerësimit të gjithanshem në formularin e paditueses.

Konkursi i paditueses ka qenë në harmoni të plotë me dispozitat ligjore te LP-03/I-212 neni 7 dhe 8 I ligjit, në pajtim me ligjin për arsimin ne komunitet e R.Kosovës nr.03/L-068 në pajtim me nenin 2 dhe 4 ku është kompetente për të vendos në fushen e arsimit dhe në pajtushmeri të plotë me nenin 5 te ligjit pika c) punësimin e mesimedhenesve dhe personelit tjetër të shkollave në pajtushmeri të plotë me procedurat ligjore të rekrutimit, perzgjedhjes dhe punësimit të të punësuarve publike. As këtu nuk kemi kurrfarë shkeljesh ligjore nga e paditura dhe ajo ka vepruar në pajtim me këtë ligj dhe nuk pranohen pretendimet e paditeses si të tilla sepse ato janë të pa bazuara me asnjë provë vetem në deklarim se ka shkelje e kjo nuk mjafton për gjykatën dhe nuk i pranon si te tilla.

Nuk ka bere shkelje as te ligjit nr.04/L-032 Per Arsimin Prarauniversitar ne R. Kosoves e paditura siq pretendon paditesja ne nenin 35 te ligjit sipas te cilit nen kerkohet qe zgjedhja nder të tjera edhe e

mesimdhënesve par.1 të bëhet përmes një konkursi publik, në bazë të merites personale pa asnjë lloj diskriminimit të drejtpërdrejtë apo terthortë lidhur me gjinin, racen vendin e lindjes etj. Kurse në paragr.5 të nenit 35 thuhet se: Kur bëhet zgjedhja në mes të një apo më shumë kandidatëve për mesimdhënes merren për bazë kushtet si janë: Arsimitimi i secilit kandidat, përvoja, kualifikimet për pozitë dhe nevojat që do të plotësojnë ky emerim. Kjo dhe ka ndodhur sipas konkursit të paditues dhe perzgjedhja është bërë në pajtim me këtë dispozitë të nenit 35 par.5. për tu zgjedh një kandidat nuk vlerësohet vetëm një kusht siq pretendon paditesja por gjitha kushtet dhe kriteret e kerkuara siq ka qenë puna në rastin konkret me formularin e paditues ku janë kanë të caktuara një numer prej 7 qeshtjesh dhe në fund është bërë grumbullimi i pikeve dhe a i që ka pasur më së shumti pikë është zgjedh si mesimdhënes e në rastin konkret M.R. që ka tubuar 23 pike kurse paditesja 18 pike edhe pse i është vlerësuar pergaditja shkollore me më shumë pikë se kunderkandidati por nuk ka pasur pikë në kushtet dhe grupimet tjera në formular.

Konkursi i shpallur me nr.05-226 dt.27.08.2015 nga e paditura Komuna e Podujevës - DKA ka qenë i shpallur publik dhe në harmoni me ligjet e cekura më lartë dhe në pajtushmeri me UA të MASHT-it nr.06/2015 për normativin Mbi Kuadrin Profesional të Arsimit të Pergjithshem sipas nenit 5 par. 10 pika. 1 dhe 2 dhe në këtë konkurs siq shifet janë hapur dhe vendet e lira për nder të tjera për dy (2) shkollat ku ka konkuruar paditesja dhe atë SHFMU "L.P." në D. nen nr .rendor 14 ku në piken nen 2 është kerkuar një mesimdhënes për Histori për 10 orë dhe në SHFMU "N.G." në fsh.B. që të dyja shkollat Komuna e Podujevës, me nr.rendor18 dhe prapë nen piken 2 është kerkuar një mesimdhënes-arsimtar i Historisë. Perzgjedhja e kandidatëve është bërë në pajtim me UA të MASHT-it 06/2015 e jo sipas UA që pretendon paditesja se e paditura ka bërë shkelje ligjore, sepse ato udhëzime nuk kanë fuqi retroaktive dhe siq u tha edhe më lartë qdo vitë nxirret UA i ri për vitin e ri shkollor dhe ka qenë edhe njoftimi në konkurs në faqen e fundit se kandidatet që i plotësojnë kushtet sipas UA te MASHT-it 06/2015 do të ftohen në intervistë dhe për këtë ka pasur njohuri dhe dijeni dhe paditesja se cili UA do të vlej në këtë konkurs dhe në intervistime.

Sipas nenit 14 te UA 06/2015 faqja e fundi e udhëzimit nr28 thuhet se:“Me hyrjen në fuqi të ketij UA Shfuqizohet UA nr.09/2014 dt.26.02.2014, normativi mbi Kuadrin Profesional të Arsimit të Pergjithshem dhe thuhet se ky UA hyn në fuqi 7 ditë pas nënshkrimit nga ministri derisa ai ishte nënshkruar nga Ministri i Arsimit me dt.10.07.2015”. Qka do të thotë se UA 09/2014 dhe UA 17/2009 dt.28.08.2009 kanë qenë për rastin në fjalë jashtë fuqie dhe nuk kanë mundur të zbatohen siq pretendon paditesja gabimisht.

Paditesja ska mundur ti ndryshoj kushtet e konkursit të shpallur nga e paditura dhe ajo në këto kushte dhe ka aplikuar. Sa i përket qeshtjes së ngritur nga GJ. Apelit Kosoves në Prishtinë në aktvendimin e saj se ka pasur listë të ngushtë të kandidatëve e paditura është pergjigjur se mund të pranohet për mesimdhënes vetëm një kandidat i vetëm dhe nuk kanë kriteret të parakualifikimit por formular prej 7 pikash që vlerësohen kandidatet dhe secila komunë e ka formën e vet të vlerësimit. Pra në nuk kemi vendim për kriteret të parakualifikimit siq prezentoj paditesja në shkresat e lëndës Aktvendimin e Komunes së Prishtinës. Për këtë e paditura si provë i ka ofruar gjykates dhe palës paditëse përmes parashtresës së dt.27.07.2018 sipas kërkesës së drejtuar nga perfaqësuesi i saj drejtorit të DKA në Podujevë. Pyetja ishte se a ka pasur e paditura dhe a ka seleksionim për mesimdhënes dhe personat tjerë profesional të Drejtorisë së Arsimit dhe i ka dhënë pergjigje se nuk ka pasur seleksionim dhe të gjithë kandidatet janë ftuar për intervistim duke paraqitur listen e kandidatëve që kanë qenë në intervistë dhe paditesja është e shënuar në numrin rendor 10 dhe koha e intervistes së mbajtur kurse kandidati i pranuar M.R. nr.rendor nen 1, po ashtu deklaroi se formularet e vlerësimit nuk janë të njëjtë nëpër Komuna.

Nga e gjithë kjo u vertetua se e paditura nuk ka bërë shkelje të dispozitave ligjore por kandidati i pranuar është në pajtim të plotë me këto ligje që pala paditëse pretendon se ka bërë e paditura shkeljen e tyre dhe kjo zgjedhje është bërë në pajtim me UA te MASHT-IT 06/2015. Andaj paditesja nuk pati të drejtë në asnjë nga pretendimet e saj dhe ju refuzua kërkesepadia si e pa bazuar në tersi siq është cekur dhe në dispozitiv të ketij aktgjykimi në mungesë të provave siq kërkohej prej paleve ndërgjyqjese me nenin 7.1 lidhur me nenin 319 par.1 dhe 2 te LPK –se. Sa i përket të paditues e njejta i beri të bazuara kundërshtimet dhe

deklarimi i saj ishte në tërësi në përputhje dhe provat tjera materiale të cila tregjenden në shkresa të lendes dhe për këtë gjykatës i dha besimin kundërshtimeve të saja dhe i mori si të bazuara.

Vendimin gjykata qe secila pale i bartë shpenzimet e veta procedurale u mor konform nenit 450 të LPK – se lidhur me UA 01/2017 TE KGJK –së, për unifikim të taksave gjyqësore.

Nga sa u tha me lartë u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË - DEGA PODUJEVË
Departamenti i Përgjithshëm – Divizioni Civil
C.nr.203/18 dt.25.10.2018

Gjyqtari:
Binak Duqi

KËSHILLA JURIDIKE:

Kundër këtij aktgjykimi palët e pakënaqura kanë të drejtë ankese në afat prej 7 ditësh në Gjykatën e Apelit të Kosovës në Prishtinë, e nëpërmes kësaj Gjykate.